



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 71, Datë 13.03.2023

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “NATYRE ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe neneve 10 dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 567/5 prot., datë 07.03.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “NATYRE ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 58, datë 24.02.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NATYRE ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 10.02.2023 dhe 11.02.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 19.02.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të

energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të Rregullores.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “NATYRE ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c”, dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.4, gërmat “a”, “b”, “c”, dhe “d”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “NATYRE ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI